

Ku qëndron rëndësia e teorisë së komunikimit?

Teoria e komunikimit definon marrëdhëniet e ndryshme të cilat krijohen midis palëve të interesuara gjatë procesit të transmetimit të informatës.

Si ndahet teoria e komunikimit?

Teoria e komunikimit ndahet në teorinë e informatave, teorinë e kodimit dhe teorinë e shenjave (semiotika).

Cilat probleme mbizotërojnë në teorinë e informatave?

Në teorinë e informatave mbizotërojnë problemet e stohacitetit (probabile) të informatave.

Kush e themeloi teorinë e informatave?

Teorinë e informatave e themeloi Klod Shanoni.

Kur u formua teoria e informatave?

Teoria e informatave u formua në vitin 1948.

Çka propozoi Shanoni?

Shanoni propozoi që informatat të maten me teorinë e probabilitetit.

Çka definon teoria e kodimit?

Teoria e kodimit definon mënyrën e shprehjes së përmbajtjes së informatës në mënyrë që këto të mund të transmetohen lehtë nëpër kanalet e komunikimit.

Çka definon teoria e shenjave?

Teoria e shenjave definon elementet e paraqitjes së përmbajtjes së informatave në mënyrë që të mundësohet lidhja e tyre që të jetë e kuptueshme.

Çka përfshin procesi i marrjes së vendimit?

Procesi i marrjes së vendimit përfshin vendosjen racionale, intuitive dhe heuristike.

Kur është vendosja racionale?

Vendosja racionale paraqet mënyrën e marrjes së vendimit kur kemi informata të plota.

Kur është vendosja intuitive?

Vendosja intuitive paraqet mënyrën e marrjes së vendimit kur nuk kemi informata të plota.

Çka synon teoria heuristike?

Teoria heuristike synon harmonizimin e dy të parave (vendosjes racionale dhe intuitive) gjatë procesit të marrjes së vendimeve.

Çka definojnë teoria e programimit?

Teoria e programimit definojnë mënyrën e shfrytëzimit të informatave që i kemi në dispozicion.

Si ndahet teoria e programimit?

Teoria e programimit përmban teorinë e algoritmeve dhe teorinë e automateve.

Çka është algoritmi?

Me algoritëm nënkuptojmë rregullën, rendin dhe teknologjinë për zgjedhjen graduale të një problemi të caktuar.

Si ndahet teoria e LSP-së?

Teoritë e LSP-së klasifikohen në teorinë teknike të LSP-së dhe teorinë sociale të LSP-së.

Tregoni formulën e modelit të rritjes dhe zhvillimit?

Modeli i rritjes dhe i zhvillimit jepet me formulën:

$$A = B(1 + i)^n$$

Tregoni modelet teorike të TPS-së (konceptet)?

Modelet teorike të TPS-së (konceptet) janë: funksionimi i sistemit, entropia e sistemit, LSP-ja, marrëdhënia me rrethinën, parimi i specializimit dhe diferencimit, parimi holistik, parimi teleologjik, parimi i ekuifinalitetit, hierarkia e sistemit.

Si definohet Informatika si shkencë?

Informatika definohet si shkencë mbi mbledhjen, përpunimin, bartjen dhe shfrytëzimin e informatave me pajisje teknike në kuader të sistemit informatik.

Kur u formua Informatika si shkencë?

Informatika si shkencë u formua në vitet '50 të shek. XX

Si definohet Informatika e biznesit si shkencë?

Informatika e biznesit definohet si shkencë mbi mbledhjen, përpunimin, bartjen dhe shfrytëzimin e informatave me pajisje teknike në kuader të sistemit informatik në një rrethinë afariste.

Përmendi disa nga profesionet e Informatikës?

Disa nga profesionet e Informatikës janë: prodhuesit e informatave, përpunuesit e informatave, shpërndarësit e informatave, punëtorët e infrastrukturës informatike.

Çka kuptoni me varshmërinë informative?

Me varshmëri informative kuptojmë pamundësinë e plotë ose të pjesërishtme të kryerjes së aktiviteteve pa përdorimin e Informatikës.

Përmendi disa trende pozitive në zhvillimin e teknologjisë informative?

Trendet pozitive në zhvillimin e teknologjisë informative janë:

- përfshirja e elementeve të Informatikës në një numër gjithnjë më të madhë të produkteve të reja dhe shërbimeve,
- zhvillimi i një numri më të madh të produkteve të reja ku si bazë është përdorimi i teknologjisë informative,
- rritja e ndikimit të teknologjisë informative në ndryshimin e marrëdhënieve në prodhim,
- rritja e ndikimit të teknologjisë informative në zvogëlimin e shpenzimeve dhe në rritjen e efikasitetit,
- ndryshimi i rolit të menaxhmentit në sistemin afarist.

Përmendi disa trende negative në zhvillimin e teknologjisë informative?

Trendet negative në zhvillimin e teknologjisë informative janë:

- rreziku nga keqpërdorimi i teknologjisë informative,
- kriminaliteti kompjuteristik,
- zvogëlimi i komunikimit verbal midis njerëzve (izolimi social i njeriut),
- rritja e forcës së individit (mbizotërimi mbi të tjerët).

Çka është e dhëna?

E dhëna është një pasqyrim i koduar i ndonjë atributi të sistemit ose të elementeve të tij , është një fjalë , një numër, apo një shenjë.

Çka është informata?

Informata definohet si raport, porosi ose e dhënë mbi gjendjen e sistemit ose zhvillimin e ndonjë ngjarje të caktuar.

Cili është raporti midis të dhënës dhe informatës?

Të dhënat nuk janë informata, të dhënat mund të shndërrohen në informata vetëm pas përpunimit të tyre, kurse informatat përbëhen vetëm nga të dhënat të cilat nevojiten.

Si krijohet informata?

Informata krijohet duke i vu në relacion të dhënat.

Cili është roli kryesor i informatës?

Roli kryesor i informatës është të provokojë dhe të nxitë aktivitete qeverisëse në lidhje me sëndërtimin e qëllimit të caktuar.

Cili është funksioni kryesor i informatës?

Funksioni kryesor i informatës është evitimi i pasigurisë dhe rrethanave të panjohura dhe të krijojë kushte për marrjen e vendimeve cilësore.



Cilat janë atributet e informatave?

Atributet (vetitë) e informatave janë: sasia e informatës, cilësia e informatës dhe vlera e informatës në kohë.

Si llogaritet sasia e informatave sipas Shanonit?

$$H = -\sum_{i=1}^n p_i \log p_i(x_i)$$

Çka është negentropia?

Negentropia është sinonim i informatës.

Çka është biti?

Biti është njësi elementare për matjen e sasisë së informatave.

Cilat janë njësitet më të mëdha se biti?

Njësitet më të mëdha se biti janë: tetrada, bajti, gjysëm fjala, fjala.

Kur është entropia maksimale?

Entropia është maksimale nëse gjasat e paraqitjes së ngjarjeve nga bashkësia e ngjarjeve të mundshme janë të barabarta.

Cili është raporti midis pasigurisë dhe cilësisë së informatës e cili midis probabilitetit dhe cilësisë së informatës?

Vlera e informatës është në proporcion të drejtë me pasigurinë dhe në proporcion të zhdrejtë me probabilitetin.

Kur themi se informatat janë cilësore?

Informata është cilësore në qoftë se funksioni i informatës është i atillë që e eviton pasigurinë.

Çka është me rëndësi për vlerën e informatës në kohë?

- Vlera e informatës çmohet në teorinë e vendosjes, vjen në shprehje qëndrimi subjektiv i marrësit të vendimit,
- Vlera e informatës është më e lartë nëse prezentohet në formën që më së miri i përgjigjet marrësit të vendimit,
- Informata trajtohet edhe nga aspekti se si ndikon në ndryshimin e sjelljeve të marrësit të vendimit.

Tregoni vlerën e informatës në kohë (funksioni hapësinor)?

Në hapësirën prognozuese vlera e informatës merret më herët se që është marrë vendimi, në hapësirën e kohës reale vlera e informatës merret kur merret vendimi ndërsa në hapësirën e vjetërsimit informata merret me vonesë, pas marrjes së vendimit.



Si definohet sistemi i komunikimit?

Sistemi i komunikimit krijon parakushte materiale dhe energjetike për transmetimin e informatës, prej burimit të saj deri te marrësi.

Cilat janë elementet e sistemit të komunikimit?

Elementet e sistemit të komunikimit janë: burimi, koduesi, kanali i komunikimit, dekoduesi dhe marrësi.

Cilat janë llojet e sistemit të komunikimit?

Llojet e sistemit të komunikimit janë sistemet natyrore dhe artificiale të komunikimit.

Cilat janë llojet e sistemit të komunikimit sipas partnerëve komunikues?

Sistemet e komunikimit sipas partnerëve komunikues dallojnë ato unilaterale, gjysëmduplekse dhe duplekse.
